

# POLICY BRIEF

## **Potenciali i demokracisë direkte në mirëqeverisjen vendore**

*Rasti i Bashkisë Tiranë*

Indrit Puteci

---

Këshilltar i Kryetarit  
Bashkia Tiranë

**2017**

Ky publikim është përgatitur me mbështetjen e Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA), në kuadër të programit “Përdorimi efikas i hulumtimit dhe advokimit mundëson politika më të mira evropiane në nivel lokal në Shqipëri”, drejtuar pjesëmarrësve të Shkollës Shqiptare të Studimeve Politike. Programi ka për qëllim të mbështesë aktivitetet kërkimore dhe advokuese të alumnëve të Shkollës (rreth 300 drejtues të rinj nga profile dhe eksperiencia të ndryshme profesionale) me synim përmirësimin e politikave në nivel vendor.

Punimet hulumtuese u fokusuan në këtë fushë për shkak të implikimeve të rëndësishme të reformës administrativo-territoriale në nivelin e demokracisë vendore si dhe zhvillimeve të vullshme në qeverisjen vendore, të cilat kanë lidhje të drejtëpërdrejtë me shërbimet që afrohen dhe janë të prekshme nga çdo qytetar.

Alumnët e përfshirë në këtë program patën mundësi të ndiqnin në terren pranë njësive të reja vendore ecurinë dhe problematikën e hasur në zbatimin e reformës administrativo-territoriale. Duke përballur eksperiencën e tyre profesionale dhe vendosur atë në kontekstin e zhvillimeve të përditshme të njësive të reja vendore, punimet e alumnëve tentojnë që të evidentojnë shembujt pozitivë në njësi të caktuara me qëllim replikimin në njësi të tjera, si dhe të ofrojnë rekomandime konkrete për përmirësimin e praktikave aktuale.

Këto punime kërkimore synohet të prezantohen në aktivitete publike apo advokuese me pjesëmarrjen e vendimmarrësve dhe aktorëve të tjerë të rëndësishëm, të cilët vijnë nga rrjeti alumni i shkollës dhe jo vetëm. Ofrimi i ekspertizës profesionale të këtyre hulumtimeve ndaj politikëbërësve siguron gjithashtu një platformë diskutimesh për shkëmbimin e ndërsjelltë të ideve të reja. Nga njëra anë, alumnët pjesëmarrës të këtyre aktiviteteve kanë mundësinë të sjellin rekomandimet e tyre për hartuesit e politikave të rëndësishme, por njëkohësisht, edhe vetë ata bëhen më aktivë dhe shërbejnë si përçues nga lart-poshtë të këtyre ideve tek shtresat e tjera të shoqërisë. Publikimi i mëtejshëm i hulumtimeve dhe ngjallja e interesit të publikut të gjerë do të ndihmojnë në krijimin e politikave dhe vendimmarrjen e orientuar nga konsultimi me publikun si dhe angazhimin e mëtejshëm të qytetarëve në këto procese politikëbërëse.

Përmbajtja e këtij publikimi nuk pasqyron opinionin zyrtar të Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë dhe të Akademisë së Studimeve Politike. Përgjegjësia për informacionin dhe pikëpamjet e shprehura në publikim i përkasin tërësisht autorëve. Autorët falenderojnë mentoren znj. Gentiola Madhi për mbështetjen dhe sugjerimet e dhëna në hartimin e këtyre punimeve.

## PËRMBLEDHJE

Demokracia direkte është një koncept plotësisht i ri për realitetin shqiptar dhe një praktikë e munguar në hapësirën demokratike. Shembulli i Zvicrës tregon se demokracia direkte është një mekanizëm me potencial të jashtëzakonshëm për të zhvilluar demokracinë në përgjithësi e veçanërisht atë vendore. Zhvillimet e viteve të fundit në Bashkinë e Tiranës, si edhe ritmi i zhvillimit të gjithanshëm të kryeqytetit, kanë sjellë nevojën e aplikimit të demokracisë direkte. Qëllimi final mbetet zhvillimi i mëtejshëm i demokracisë vendore dhe rritja e cilësisë së jetës së banorëve të Tiranës nëpërmjet gjithpërfshirjes së tyre deri në vendimmarrjen direkte përmes referendumeve, si pjesë e ushtrimit të demokracisë direkte. Cilat janë 'stekat', kalimi i të cilave provon prezencën e demokracisë së zhvilluar?

- Demokracia nuk është vetëm zgjedhje (që ushtrohet përmes demokracisë së deleguar apo përfaqësuese), por është edhe pjesëmarrje (që ushtrohet përmes referendumeve).
- Në një demokraci të zhvilluar politikat jo vetëm që bëhen për njerëzit, por edhe bëhen nga njerëzit. Qytetarët janë subjekt dhe jo objekt i politikave dhe i shtetit.
- Në vendet me demokraci të zhvilluar të gjithë ata që lidhen në një mënyrë apo tjetër me një vendim duhet të jenë direkt ose tërthorazi pjesë e procesit të vendimmarrjes.
- Demokracia u mundëson njerëzve të jenë të lirë. Por, liri do të thotë më shumë se të kesh një zgjedhje; liri do të thotë e drejta, kapaciteti dhe mundësia për të ndikuar së bashku në një bashkëjetesë të shëndetshme.
- Vetëm duke i ftuar të gjithë të bëhen pjesë e vendimmarrjes garantohej premtimi themelor që ka të bëjë me dhënien e mundësive të barabarta për këdo. Demokracia është një proces i vazhdueshëm që nuk ka fund.

Le ta shohim në këtë këndvështrim demokracinë direkte dhe Tiranën.

## HYRJE

Si pasojë e zbatimit të reformës administrative-territoriale, hapësira e Bashkisë së Tiranës është rritur më shumë se 20 herë krahasuar me hapësirën (në kuptimin territorial gjeografik) që ajo zinte deri përpara dy vitesh. Të 24 njesitë administrative, në të cilat është ndarë Bashkia e Tiranës, përballen me problematika nga më të larmishmet dhe shpesh herë shumë sfiduese sa i takon zgjidhjeve që kërkohen. Këto mori nevojash e bëjnë më të rëndësishëm procesin e identifikimit të prioritetëve sipas këndvështrimit të qytetarëve dhe marrjen në konsideratë të zgjidhjeve që ata do të mendonin si të duhurat.

Që qasja e institucionit të Bashkisë së Tiranës dhe këshillit të saj bashkiak të prodhojë zgjidhje optimale, nevojitet përfshirja e qytetarëve si në procesin e përcaktimit të prioritetëve ashtu edhe gjetjen dhe zbatimin e zgjidhjeve. Dëgjesat dhe konsultimet publike të organizuara në të 24 njesitë administrative kanë treguar që këto praktika janë mekanizma shumë efikas për të marrë mendimin e qytetarëve, për t'u këshilluar me ta dhe për të marrë aprovimin e tyre përpara se të ndërmerret p.sh. një ndërhyrje infrastrukturore, apo përpara se të zbatohet një projekt në një zonë të qytetit. Përfshirja e qytetarëve në praktika të mirënjohura si dëgjesa publike dhe këshillimi është pozitive. Megjithatë, ende duhet mundësuar përfshirja direkte e qytetarëve në procesin e vendimmarrjes përmes aplikimit të demokracisë direkte. Zbatimi i kësaj demokracie krijon mundësinë për çlirimin e një potenciali të jashtëzakonshëm të kontributit të shoqërisë për të përmirësuar më tej cilësinë e jetës, që është edhe misioni kryesor i çdo organi të qeverisjes vendore.

## ÇËSHTJET QË ADRESON DEMOKRACIA DIREKTE DHE STATISTIKAT

Shpesh herë politika ka treguar tendencën e saj për të prodhuar konflikt përmes politizimit ekstrem, deri sa frenon ritmet e zhvillimit dhe cënon standardet e jetës së qytetarëve. Mentaliteti i një pjese të madhe të shoqërisë është që 'vendimmarrja u takon vetëm të zgjedhurve' apo atyre që mund të ushtrojnë demokracinë

e deleguar. Madje ka edhe organe që ushtrojnë demokracinë e deleguar që e konsiderojnë demokracinë direkte si 'rrezik' dhe se aplikimi i saj e kufizon ushtrimin e demokracisë së deleguar; edhe pse praktikat e vendeve me demokraci të zhvilluar kanë provuar që këto dy forma të demokracisë vetëm plotësojnë dhe krijojnë më shumë hapësirë për efikasitetin dhe produktivitetin e secilës në zhvillimin e mëtejshëm të shoqërisë. Jo rrallë ndodh që subjektet politike, përmes anëtarëve të tyre në organet që ushtrojnë demokraci të deleguar, të ushtrojnë presion përmes kushtëzimit të vendimarrjes që 'kanë në duar' jo duke u fokusuar në mënyrë të paanshme në interesin publik, por duke u munduar të çojnë ujë në 'mullirin' e forcës së tyre politike.

Bashkia e Tiranës mund të konsiderohet një 'kantier i madh ndërtimi' dhe nevojat e perspektivat e qytetit i tejkalojnë kapacitetet e organeve që ushtrojnë demokracinë e deleguar për t'ju përgjigjur ritmit dhe dinamikës së zhvillimit. Madje mund të ndodh që në vend të zgjidhjeve, politika e mbrapshtë dhe jo e përgjegjshme e disa subjekteve politike të prodhojë konflikt dhe vështirësojë apo pengojë gjetjen dhe zbatimin e zgjidhjeve. E thënë më shkuror, organet e demokracisë së deleguar mund të kthehen në kundërshtarë kryesorë të vetë demokracisë, duke abuzuar me të drejtën e përfaqësimit që u është dhënë nga qytetarët.

Hapësirat dhe shoqëritë me demokraci të avancuar shquhen nga 'prania' e një elementi shumë të rëndësishëm që është '**debati**'. Në 'traditën' shqiptare të komunikimit debati shpesh perceptohet si 'zënkë' apo 'konflikt' dhe jo si normë komunikimi konstruktive ku të gjithë kanë mundësi të japin mendimet dhe opinionet nga këndvështrimet e tyre. Gjithashtu, debati është një instrument demokratik për të dëgjuar mendime dhe opinione që janë të ndryshme apo edhe të kundërta. Debati konstruktiv mbetet 'i munguar' në shoqërinë shqiptare, çka zvogëlon mundësitë e zhvillimit dhe pengon krijimin e një ambienti shoqëror të shëndetshëm. Demokracia dhe debati janë të lidhur ngushtë me njëra-tjetrën.

Në vitet e tranzicionit ka shembuj pa fund që dëshmojnë se nuk ka qenë e lehtë apo deri e mundur që qytetarët të bëhen bashkë për të mbështetur një kauzë ose për të 'imponuar'

vendime qoftë në organet e qeverisjes qendrore qoftë ato vendore me interes të gjerë publik. Në muajt e fundit ka pasur ngjarje shumë të rënda që u kanë ndodhur individëve/qytetarëve 'të pambrojtur' duke zbuluar plagë të rënda shoqërore të trashëguara nga e shkuara për të cilat ndjeshmëria qytetare ka reaguar fare pak. Veçoj rastet e ushtrimit të dhunës në familje që kanë qenë fatale. Rasti mbase më i rëndësishëm ishte vrasja nga ish-bashkëshorti i gjyqtares znj. Fildes Hafizi. Pati një reagim deri diku në rrjetet sociale, por nuk pati iniciativa të fuqishme qytetare apo nga OJF-të për të protestuar kundër dhunës në familje e veçanërisht asaj të ushtruar ndaj grave.

Tendenca për të individualizuar '**pronësinë**' e problemit nuk është shenjë e demokracisë së zhvilluar ndaj edhe shërbimi që mund të bëjë demokracia direkte ndaj demokracisë në përgjithësi është shumë dimensional dhe me një dobi shoqërore të jashtëzakonshme.

Për të argumentuar ndryshe këtë tendencë të individualizimit të problemit le t'i referohemi të dhënave zyrtare të Bashkisë së Tiranës, ku konstatohet lehtësisht se ka një numër të lartë të kërkesave dhe ankesave që qytetarët i dërgojnë bashkisë apo kryetarit të saj. Si do të mundet, cilido qoftë organi i qeverisjes vendore, të menaxhojë dhe të zgjidhë të gjitha këto kërkesa?! A është kjo forma më e mirë e bashkëpunimit të komunitetit me organet e qeverisjes vendore që vetë i kanë zgjedhur?!

**Tabela 1** më poshtë ilustron një pjesë të shkresave (kërkesë-ankesa) hyrëse dhe dalëse në institucionin e bashkisë, numrin e shkresave që nuk kanë marrë përgjigje, thirrjet telefonike në numrin e gjelbër dhe shkresat e mbërritura me postë. Pasqyra tregon vetëm të dhënat e **3-mujorit të katërt të vitit 2016** dhe numri total arrin në **21'526** kërkesa dhe ankesa.

Po të bëjmë një përlogaritje të thjeshtë duke pjestuar numrin e kërkesave/ankesave 21'526 për numrin e ditëve të punës për periudhën tetor - dhjetor 2016, pra 72 ditë, vërejmë që janë **mesatarisht 308 kërkesa në ditë** për t'u administruar dhe zgjidhur. Edhe po të marrim në konsideratë kapacitetin e burimeve njerëzore, sigurisht që është shumë e vështirë që të zgjidhen dhe t'u jepen përgjigje të gjithë këtyre kërkesave/ankesave.

**Tabela 1:** Kërkesë ankesat e ardhura nga qytetarët për periudhën tetor-dhjetor 2016

Struktura përgjegjëse	Shkresa hyrese	Shkresa dalese	Shkresa pa përgjigje	Thirrje tek nr. i gjelbër	Posta	TOT.
Kabineti i Kryetarit	230	230	0	32	129	621
Posta e Kryetarit	93	93	0	0	0	186
Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit	3'446	3'426	20	27	74	6'993
Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale	1'626	1'622	4	47	27	3'326
Drejtoria e Strehimit Social	1'516	1'516	0	0	0	3'032
Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike	479	429	50	392	154	1'504
Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit	1'202	1'018	184	82	88	2'574
Drejtoria e Planifikimit të Territorit	181	126	55	0	0	362
Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit	737	686	51	0	0	1'474
Drejtoria GisKadastres	274	196	78	0	0	548
Policia Bashkiake	123	116	7	83	25	354
Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit	233	172	61	26	60	552
<b>TOTALI</b>	<b>10'140</b>	<b>9'630</b>	<b>510</b>	<b>689</b>	<b>557</b>	<b>21'526</b>

Burimi: Bashkia e Tiranës, 2017.

Një pjesë e mirë e këtyre **kërkesave/ankesave** kanë përmbajtje të ngjashme dhe dërguesit mjaftohen duke e sjellë problemin si individ. Në një mënyrë a në një tjetër, të gjithëve u intereson çfarë ka brenda shtëpisë së tyre, kur në fakt problemi që përcjellin është i komunitetit të zonës ku ata banojnë. Një tjetër problem i hasur është përmbajtja e paqartë e shkresave që e bën shumë të vështirë për t'u 'deshifruar' se cila është arsyeja/problematika. Në veçanti, do të përmendej pritshmëria e qytetarëve që bashkia t'i ofrojë zgjidhje problemeve ndërmjet 'fqinjëve' apo banorëve të një pallati. Sa probleme të tilla ka në një qytet të madh si Tirana?! Si do të ishte praktikisht e mundur që bashkia të zgjidhte secilin prej tyre?!

## **PSE DEMOKRACIA DIREKTE MUND TË KONSIDEROHET SI ZGJIDHJA E DUHUR?**

Bashkëjetesa komunitare duhet të jetë një realitet mbizotërues e normal në Tiranë dhe çdo bashki tjetër. Individët/qytetarët nga 'ankues' apo 'spektatorë' duhet të kenë mundësi të bëhen bashkëpunues dhe aktorë të rëndësishëm të zhvillimit vendor. Për këtë duhen

aplikuar mekanizma të ushtrimit të demokracisë direkte që u mundësojnë qytetarëve përmirësimin e cilësisë së jetesës dhe krijimit të mundësive më të mëdha për ardhmërinë e shoqërisë shqiptare.

Eksperiencat jo të mira të qeverisjeve vendore në të shkuarën i kanë bërë qytetarët të jenë skeptikë e të dekurajuar për të zgjeruar pjesëmarrjen e tyre në hapësirën e përbashkët demokratike.

Ka rëndom përfaqësues të subjekteve politike që mendojnë se 'qytetarët' nuk janë në gjendje të vendosin, pasi sipas tyre ata 'nuk kanë informacionin e nevojshëm që u duhet për të marrë vendimet e duhura'. Këta politikanë e konsiderojnë informacionin të drejtë ekskluzive vetëm për ta, e transparencën e shohin si të panevojshme. Por zgjerimi i procesit të vendimmarrjes së qytetarëve apo komunitetit dhe gjithëpërfshirja e tyre garantojnë vendime më të drejta dhe inkurajojnë përgjegjshmërinë dhe pjesëmarrjen qytetare, e ndihmojnë në krijimin e një mjedisi shoqëror e politik më pak konfliktual e më të shëndetshëm.

Mentaliteti i një pjese të shoqërisë ka ende



nuancat e sistemit të shkuar dhe duhet patjetër të ndryshojë, e kjo është sfidë jo e lehtë. Nuk është e lehtë të 'shkërmoqësh' e të 'zhbësh' mentalitetin e 'ndërtuar', apo më shumë duhet thënë imponuar, nga sistemi politik nën të cilin vuajti për një kohë të gjatë shoqëria shqiptare. Lëvizja e madhe demografike, në një pjesë të mirë të saj, ka pasur ndikim pozitiv në 'misionin' e ndryshimit të domosdoshëm të mentalitetit të cilin tranzicioni i tejzgjatur e ka frenuar të ndodh në një kohë më të shpejtë. Sipas deklarimeve publike të bëra nga Bashkia e Tiranës dhe Kryetari i saj Z. Erion Veliaj, kryeqytetit i bashkohen mesatarisht çdo ditë më shumë se 50 banorë të rinj. Sado të 'huaj' mund të ndjehen në fillimet e banimit të tyre në Tiranë shumë shpejt ata 'konvertohen' në banorë organik të Tiranës dhe ndajnë të njëjtat probleme dhe shqetësime që kanë banorët në dukje më 'të vjetër'. Të gjitha këto prurje të reja kanë vitalizuar Tiranën dhe kanë shtuar ritmet e zhvillimit të saj të gjithanshëm. Mjafton të përmendet numri i studentëve të rinj, nga gjithë Shqipëria apo edhe jashtë saj, që fillojnë çdo vit akademik studimet në universitetet publike dhe jo-publike në Tiranë.

Në morinë e problematikave me të cilat Tirana dhe bashkia e saj përballen çdo ditë, demokracia direkte sjell zgjidhje në vend të kërkesave pa fund dhe si pasojë këto përfitime:

- reduktim të shpenzimeve për burimet njerëzore që merren me trajtimin e

## KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Tirana është ajo pjesë e shoqërisë dhe hapësirës mbarëkombëtare që i ka paraprirë zhvillimit të mbarë vendit, ndaj edhe roli i saj për të sjellë në këtë hapësirë një dimension të ri të ushtrimit të demokracisë merr rëndësi të veçantë. Kush më mirë se Bashkia e Tiranës mund të jetësojë praktikën e ushtrimit të gjerë të pjesëmarrjes dhe vendimarrjes qytetare përmes ushtrimit të demokracisë direkte?!

Ushtrimi i kësaj forme të demokracisë siguron përcaktimin e prioritetëve sipas këndvështrimit të qytetarëve dhe mundëson dhënien prej tyre të kontributit më të plotë në dobi të zhvillimit të gjithanshëm e të mëtejshëm të

kërkesave dhe ankesave;

- kursim të kohës së qytetarëve dhe reduktim të shpenzimeve që lidhen me procedurat e aplikimit;
- ushtrim direkt të vullnetit të qytetarëve për çështje që kanë lidhje direkt me to.

Demokracia direkte do t'u krijojë mundësinë individëve që të advokojnë në komunitetet ku ata banojnë për të marrë mbështetjen e nismave të tyre dhe ua përcjellin më pas organeve përkatëse të qeverisjes vendore, për të marrë vlerësimet dhe argumentet në përgjigje të tyre dhe të vendosin nëse duan ta zhvillojnë nismën deri në referendum të shtrirë në atë hapësirë (në një apo disa njësi administrative) të Bashkisë Tiranë, ku çështja është me interes të veçantë publik.

*Vendimmarrja përmes demokracisë direkte është më e drejtë, më e paanshme, më profesionale e produktive dhe krijon sinergji. Gjithashtu, përmirëson klimën politike duke balancuar pushtetin dhe duke rritur për këdo mundësinë e dhënies së kontributit në procesin e zhvillimit të përgjithshëm social – ekonomik.*

Balancimi i pushtetit përmes aplikimit të demokracisë direkte ndikon ndjeshëm edhe në përmirësimin e klimës politike dhe mjedisit shoqëror për të krijuar hapësirën e nevojshme që demokracia vendore të zhvillohet më tej dhe të 'pushtojë' Tiranën.

Tiranës. Inkurajon dhe krijon mundësinë që individët të integrohen në grupe komunitare ku e kanë shumë më të lehtë të bashkëpunojnë me organet e qeverisjes vendore, të identifikojnë probleme që kanë një ndikim më të gjerë në shoqëri e të gjejnë zgjidhjet më racionale si dhe të marrin vendimet e duhura.

Demokracia direkte e inkurajon debatin mbi çështje dhe rrethana që kanë interes të konsiderueshëm në komunitet. Ajo është një formë e avancuar e komunikimit ndërmjet palëve, edhe kur janë në pozita të kundërta, përse i takon interesave që mbështesin. Gjithashtu u jep mundësinë e nevojshme palëve që të prezan-

tojnë në publik argumentat e tyre pro dhe kundër për çështje specifike që mund të jenë objekt i propozimeve konkrete apo vendimeve nëpërmjet organizimit të referendumeve.

Këto janë rekomandimet për Bashkinë e Tiranës për të zbatuar demokracinë direkte:

- Në mënyrë që koncepti i demokracisë direkte të pranohet e përqafohet nga qytetarët e Tiranës, si për çdo koncept të ri, është e nevojshme një fushatë sensibilizimi përmes takimeve të drejtpërdrejta dhe përdorimit të të gjithë elementëve të mundshëm për sensibilizimin dhe informimin. Është e nevojshme të organizohen takime të veçanta me anëtarët dhe kryetarin e Këshillit Bashkiak të Bashkisë së Tiranës.
- Duke qenë se mungon baza ligjore për ta bërë 'të detyrueshëm' aplikimin e demokracisë direkte rekomandohet të përzgjidhen një ose dy njësi administrative të Bashkisë së Tiranës për t'u konsideruar si njësi pilot. Për të mbuluar më mirë tipologjinë e Bashkisë së Tiranës dhe mundësuar zbatimin e demokracisë direkte do të ishte e nevojshme që një njësi administrative të përzgjidhej nga ato njësi që i përkasin hapësirës urbane të Tiranës dhe një nga ato njësi që i përkasin hapësirës rurale të saj. Në këtë mënyrë do të merrej njëkohësisht reagimi nga banorë të Tiranës që banojnë si në zonat urbane ashtu edhe ato rurale. Me gjithë ngjashmëritë që mund të ketë ndërmjet problematikave që paraqesin të dy zonat apo hapësirat me karakteristika thellësisht të ndryshme në kuptimin demografik, ekonomik dhe social, sigurisht ka edhe ndryshime të

rëndësishme dhe çështje që do të bëheshin objekt i zbatimit të demokracisë direkte. Shumë interesante është të mendosh që në një të ardhme të shpejtë banorët e zonave urbane dhe rurale do të bashkonin zërin dhe vullnetin e tyre për të adresuar çështje për të cilat të dy komunitetet e këtyre zonave do të kishin interes të përbashkët.

- Duke qenë se shumë herë ritmet e zhvillimit të një vendi janë shumë të lidhura me aksionin qytetar të të rinjve të një komuniteti, do të duhet të organizohen në mënyrë të veçantë takime të hapura debati mes të rinjve të shkollave të mesme dhe padyshim, studentëve.
- E gjithë e drejta e të shprehurit të vullnetit të banorëve të Bashkisë së Tiranës do të duhet të mundësohet në formë sa më komode për ta. Për këtë shihet si zgjidhje optimale zhvillimi i një software/aplikacioni që mundëson votimin elektronik në rastin që iniciativa e një grupi qytetarësh shkon deri në referendum.
- Kryetari i Bashkisë së Tiranës, si i zgjedhuri i vetëm nëpërmjet ushtrimit të demokracisë direkte, përmes zgjedhjeve vendore, ka tagrin e duhur për t'i ftuar banorët e kryeqytetit të bëhen pjesë e ushtrimit të demokracisë direkte në dobi të tyre dhe gjithë qytetit të Tiranës.
- Për të monitoruar procesin dhe për të siguruar transparencën e nevojshme, përfaqësues të shoqërisë civile rekomandohet të ndjekin nga afër të gjitha hapat dhe mund të japin në fund komentet dhe sygjerimet e tyre për përmirësime të mundshme.

## BURIMET

- Aplikacioni 'Tirana ime' i disponueshëm tek: <http://www.tirana.al/aplikacioni-tirana-ime/>
- Portali i të dhënave të hapura të Bashkisë së Tiranës: <http://opendata.tirana.al/?q=search/type/dataset>
- Bruno Kaufman, "How direct democracy makes Switzerland a better place", The Telegraph, 27 Maj 2007: <http://www.telegraph.co.uk/news/1435383/How-direct-democracy-makes-Switzerland-a-better-place.html>